REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

***KOMUNA E ISTOGUT** në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson z. Gëzim Ademaj, U.D. i menaxherit të Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;*

Dhe

"TONI INGJINJERIG" SHPK nga Negroci, Komuna e Drenasit të cilën e perfaqëson z. Malush Krasniqi, me Nr. Rexh. Biznesi, 810199861 (ne vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

NDËRTIMI I NDRIQIMIT PUBLIK NË ISTOG TE POSHTËM

Nr. I prokurimit	*633-20-6706-5-2-1/ C410*
Nr. I brendshëm	*633 / 020 / 056-R 521*

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

NDËRTIMI I NDRIQIMIT PUBLIK NË ISTOG TE POSHTËM Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi I kontrtës per aktivitetin e prokurimit: ***NDËRTIMI I NDRIQIMIT PUBLIK NË ISTOG TE POSHTËM është 10.527,00 €***
dhe me shkronja:
Dhjetëmijëepesëçindenjëzeteshtatëzerzeroeuro €

2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit te kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës:

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Kohëzgjatja e Kontratës:

4.1. ***Kontrata do të fillojë të realizohet menjëherë pas datës së nënshkrimit të saj, dhe të gjitha punimet sipas kësaj kontrate do të përfundojnë me datë, 20.12.2020***

Neni 5. Ndërprerja e kontratës:

5.1 ***Kjo kontratë mund të shkëputet kurdo here në qoftë se kontraktori nuk i respekton kushtet e pergjithshme dhe te veqanta te kontratës të dosjes së tenderit, dhe kur per një gjë të tillë plotesohen këto kushte, duke pas parasysh edhe sanksionet e parapara per dëmet qe eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues.***

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të

gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të

interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për Kontraktuesin:
"TONI INGJINJERING" Shpk

Emri:	***Gëzim Ademaj***	***Emri:***	***Malush Krasniqi***
Pozita:	***U.D.*** ***I Menaxher-it të Prokurimit***	***Pozita:***	***D r e j t o r***
Nënshkrimi:		***Nënshkrimi:***	
Data:	20. 11. 2020	***Data:***	20.11.2020
Vu la	REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPSTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO	***V u l a***	SH.P.K. TONI INGJINJERING ISTOG

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është *10% e vlerës së përgjithshme të kontratës* **10% e vleres se kontrates, me vlefshmeri 30 dite me gjate perfundimi i kontrates.**
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të caktohet në *planin e menaxhimit*
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë *1muaj*
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është *i caktuar me vendim të ZKA*
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë *5DITE* pas nënshkrimit të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë

	NDERTIMI I NDRICIMIT PUBLIK NE ISTOG TE POSHTEM.				
Nr.	Pershkrimi i puneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Punimi i bazamentit të Ormanit së ndriçimit me dim. (0,80x0,60x0.2) m nga betonarmeja C30/37.	copë	1	20.00 €	20.00 €
2	Porosia dhe shtrirja e kabllos për furnizim prej TS ma të afërt deri te Ormani I grupit matës I ri me kabëll PP00 4x50 mm² komplet	m	40	1.50 €	60.00 €
3	Porosia dhe montimi i Kuadrit qendror për furnizimin e ndriçimit publik sipas 1)skicës në detal, 2)skemës 1 polëshe-, në detal me pjesën e gjamit shtesë nga jasht për leximin e njehsorit,pjesën e zbrazur rezervë të mbrojtur e zingtuar pastaj e pjeku me ngjyrë me dim (120.x90x30). 1 - Ndërprerës AS-160A 1 -Transformatorë rrymorë /5 A 3 - Mikrondërpresë /A 1 - Portllampë E27 1 - Poç fluroshent 1x18w me baze 1 - Prizë OG 16 A 1 - Voltmetër Vm 0-500 V 1 - Ampermetër Am 0-200A 1 - Ndërp. Zgjedhës për Am80A-u-R10 1 - Ndërprerës tipi GS-16-66 U 1 - Sig. Tripolare automatike /A te vendosura ne kuti per 3 siguresa komplete 3 ORS siguresa 9 patron /A - Siguresa njëpolare automatike 10-16A 6 copë - Përçues 1x25 mm 2 (m) 50 - Kontaktorë tip CS 160 ose 100A 3 - Ndërprerësi automatik/A 1 -Porosia e ORG 3 siguresa 63Anër trafo	copë	1	150.00 €	150.00 €
	Demolimi I kubzave të betonit, hapja e kanalit, shtrirja e infrastruktures nënëtoksore dhe kthimi I gjendjes paraprake pasi të jetë shtrir ifrastruktura e ndriqimit publik	m'	750	0.70 €	525.00 €
4	Hapja dhe germimi i kanalit (0.4x0.8)m per shtrirjen e kabllos se ndricimit publik si dhe kthimi ne gjendjen e me parshme	m'	1020	2.00 €	2,040.00 €
5	Punimi I bazamentit të shtyllës së ndriçimit me gypa Ø250/0.8m dhe duke e betonuar bazamentin e shtylles me dimensione (0.8,0.8,0.8)m, ndersa në brendesi të gypit mbushje me rërë të imet pasi të jetë vendosur	copë	23	35.00 €	805.00 €
6	Porosia dhe shtrirja e gypave PVC të brinjëzuar Ø 63 mm per vendosjen e kabllove te ndricimit	m	1040	0.60 €	624.00 €
7	Porosia dhe shtrirja e shiritit plastik vrojtues për ekzistimin e kabllove energjetik përgjat linjës, mbi kabëll.	m	1040	0.05 €	52.00 €



8	Porosia dhe shtrirja e rërës së imët nënë dhe mbi kabllo të ndriqimit	m3	25	5.00 €	125.00 €
9	Porosia dhe shtrirja e kabllos për furnizimin e secilës shtyllë, prej Ormanit të grupit matës deri te shtylla e fundit, me kabëll PP00 4x16 mm2 Al komplet me papuçe dhe material tjetër të nevojshëm	m	1320	1.10 €	1,452.00 €
10	Furnizimi dhe montimi I shtyllave të hekurta , për ndriçim në lartësi 8.5 m, te zinguara (galvanizuara), në shtylla duhet të jetë llogaritur edhe lira (mbajtësi trupave ndriçues) një krahëshe, klembert, siguresë FRA 16 A, kabëll PP-Y 3x2,5 mm2 dhe material tjetër I nevojshëm, e në tërësi	copë	23	140.00 €	3,220.00 €
11	Furnizimi transporti dhe montimi i trupave ndriquese në shtylla për ndriçim, të kualitetit të lartë, ekonomike, me LED 50 W, të tipit ZGZM LLD 50 W (ose I tipit tjetër me karakteristika të njejta), në përputhshmëri me sdandartet CE dhe me mundësi të rregullimit të kandit, nga në të dy rrafshet.	copë	23	30.00 €	690.00 €
12	Furnizimi dhe montimi I klemeve VAGO per lidhjen e trupit ndriques me kabllo 3x1.5mm2		90	0.10 €	9.00 €
13	Furnizimi transporti dhe vendosja e shiritit per tokezimFe/Zn 25x4 mm.	m	1020	0.60 €	612.00 €
14	Furnizimi transporti dhe montimi I përquesit tip PPOO 3x2.5mm2 të vendosura në shtyllë	m	225	0.60 €	135.00 €
15	Porositja dhe realizimi I atesteve te tokezimit dhe te izolimit te kabllove	copë	1	8	8.00 €
TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT					10,527.00 €

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK(OE)	
Emri I Kompanisë	"TONI INGJINJERING"SH.P.K
Adresa e plotë	Negrofc - Drenas (Gllogoc)
Përfaqësuar nga:	
EMRI DHE MBIEMRI	Malush Krasniqi
Pozita	Pronar
Data	03.11.2020
Nënshkrimi	
Vula	